



Prot. Nr. 48

Tiranë më: 17.04.2025

**Lënda:** Njoftim për hapjen e thirrjes së 11-të - për aplikime në Programin e Trajnimit të Detyrueshëm Përgatitor për Certifikim për drejtues të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar 1 – 31 Maj 2025.

### MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT

Rruga e Durrësit 23, Tiranë

### AGJENCISË KOMBËTARE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR ✓

Rr. "Aleksandër Moisiu". përballë IKV, Tiranë

Bazuar në Nenin 12, pika 2 e Rregullores "Për Zhvillimin Profesional dhe Kualifikimin e Drejtorëve/Nëndrejtorëve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar në Shqipëri", Shkolla e Drejtorëve të IAP, hap më **1 MAJ 2025 thirrjen e 11-të** për aplikime për pjesëmarrje në Programin e Trajnimit të Detyrueshëm Përgatitor për Certifikim për drejtues të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar.

Thirrja do të jetë e hapur për drejtues në detyrë në Institucionet e Arsimit Parauniversitar dhe kandidatët për drejtues të IAP-ve që janë mësues të kualifikuar dhe ushtrojnë ose e kanë ushtruar profesionin e tyre, si në institucionet publike dhe në ato private.

Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtëm për të aplikuar për pjesëmarrje në programin e trajnimit:

- ✓ Kanë përfunduar në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të dytë ose kanë ndjekur një program studimi 4 vjeçar në fushën e mësuesisë dhe janë pajisur me diplomën përkatëse, ose janë diplomuar jashtë vendit në një program të ciklit të dytë në fushën e mësuesisë dhe kanë kryer njehsimin e diplomës pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

Center for School Leadership  
+355 4 220 9185  
info@csl.edu.al

Adresa: Bulevardi "Zhan d'Ark", Nr. 23, Tiranë, Shqipëri

www.csl.edu.al



- ✓ Kanë përvojë punë si mësues dhe kanë së paku kategorinë "Mësues i Kualifikuar". Nuk kanë masa disiplinore në fuqi në momentin e aplikimit.
- ✓ Të kenë notë mesatare aritmetike të studimeve të ciklit të parë dhe të dytë ose ekuivalent me to jo më pak se 7.5 (Kriter preferencial).

Aplikimi për Programin e Trajnimit do të kryhet online përmes faqes zyrtare të Shkollës së Drejtorëve, seksioni përkatës i aplikimit <https://www.csl.edu.al/>

Bazuar në Nenin 12, pika 2 e Rregullores "Për Zhvillimin Profesional dhe Kualifikimin e Drejtorëve/Nëndrejtorëve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar në Shqipëri", **thirrja do të jetë e hapur për një periudhë 30 ditore, nga data 1 – 31 Maj 2025.**

Bazuar në Nenin 14 të Rregullores "Për Zhvillimin Profesional dhe Kualifikimin e Drejtorëve/Nëndrejtorëve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar në Shqipëri", aplikimet do të shqyrtohen nga Komisioni i Vlerësimit të kandidatëve brenda afatit 30 ditor nga mbyllja e aplikimeve, sipas kategorive dhe pikëzimit të përcaktuar në nenin 14 të rregullores së sipërpërmendur.

Komisioni i Vlerësimit të aplikimeve përbëhet nga 2 përfaqësues të MAS dhe një përfaqësues nga Shkolla e Drejtorëve të IAP dhe në varësi të numrit të aplikimeve, Shkolla e Drejtorëve mund të krijojë më tepër se një komision vlerësimi me qëllim vlerësimin e aplikimeve brenda afatit të përcaktuar në rregullore.

Shkolla e Drejtorëve të IAP, në varësi të numrit të komisioneve të vlerësimit që do të jetë e nevojshme të krijohen, do të kërkojë nga MAS të ofrohen anëtarët e komisionit që do të marrin pjesë në vlerësim.

Informacioni i detajuar në lidhje me thirrjen ofrohet në faqen e zyrtare të internetit të Shkollës së Drejtorëve të IAP në adresën [www.csl.edu.al](http://www.csl.edu.al).

Shkolla e Drejtorëve të IAP do kryejë njoftimin për hapjen e thirrjes në të gjitha kanalet e informimit si dhe duke e promovuar atë.



Sa më sipër, gjykojmë se falë bashkëpunimit me ju dhe institucioneve në varësinë tuaj, përcjellja e informacionit për hapjen e thirrjes do të mund të arrijë në të gjithë drejtuesit e mësuesit e interesuar nëpërmjet komunikimit tuaj të brendshëm ndër-institucional.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

Me konsideratë,

  


DREJTOR EKZEKUTIV  
Dr. Jola Kepi